



Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datë: 12.02.2014
Nr. 0204-188

PËR: **Rufki Suma**, Kryetar i Komunës së Hanit të Elezit
Qamush Brava, Kryesues i Kuvendit të Komunës së Hanit të Elezit

LËNDA: **KONFIRMIMI I LIGJSHMERISË SË VENDIMIT TË KUVENDIT TË KOMUNËS SË Hanit të Elezit Nr. 465/2014**, të pranuar më datën 07.02.2014

Të nderuar,

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal duke u bazuar në kompetencat dhe përgjegjësitë të përcaktuara në Ligjin Nr. 03/L-040 për Vetëqeverisje Lokale, si dhe Rregulloren Nr. 02/2011, për Fushat e Përgjegjësisë Administrative të Zyrës së Kryeministrit dhe Ministrive shtojca XII, pas shqyrtimit të vendimit Nr. 465/2014 të miratuar me datën 31.01.2014 nga Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit, **KONFIRMON** ligjshmërinë e aktit dhe vlerëson se i njëjti është në harmoni me Ligjin për Vetëqeverisje Lokale.

Akti juridik i cili prodhon efekt të plotë juridik është si në vijim:

- Vendimi me Nr. 465/2014 për caktimin e kriterëve për shpalljen e konkursit për komitetet konsultative.

Me respekt,

Slobodan Petrović,
Zëvendëskryeministër dhe Ministër i MAPL-së

Kopje: *Besnik Osmani, Sekretari i Përgjithshëm në MAPL*
Udhëheqësve të Departamenteve të MAPL-së
Arkivit të MAPL-së



DALËSE-IZLAZNA-OUTGOING
REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA/REPUBLIC OF KOSOVA
QEVERIA E KOSOVËS/VLADA KOSOVA/GOVERNMENT OF KOSOVA

Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Lokalne Samouprave i Administracije
Ministry of Local Government Administration

Nr. Br. No. 0204-188/3
Data Datum Date 24.02.2014

-VI-

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria - Vlada - Government
Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal
Ministarstvo Administracije Lokalne Samouprave
Ministry of Local Government Administration

Datum: 12.02.2014
br. 0204-188

Za: **Rufki Suma, Gradonačelnik opštine Elez Han**
Qamush Brava, Predsedavajući Skupštine opštine Elez Han

Predmet: **Potvrda zakonitosti odluke Skupštine opštine Elez Han**
br. 465/2014, primljeno dana 07.02.2014

Poštovani,

Ministarstvo administracije lokalne samouprave na osnovu nadležnosti i odgovornosti definisano članom 76.1 zakona o lokalnoj samopupravi, kao i prema uredbi br. 02/2011, o odgovornim administrativnim oblastima kancelarije premijera i Ministarsva dodatak XII, nakon razmatranja odluke br. 465/2014 odobreno dana 31.01.2014 od strane Skupštine opštine Elez Han, **POTVRĐUJE** zakonitost akta i procenjuje da isti taj je u potpunom skladu sa zakonom o lokalnoj samoupravi.

Pravni akt sa potpunim pravnim dejstvom je kao što sledi:

Odluka br. 465/2014 za određivanje kriterija objavljivanja konkursa za konsultativne odbore.

Sa poštovanjem

Slobodan Petrović,
Zamenik premijera i Ministar MALS-a

Kopije: *Besnik Osmani, Generalni sekretar MALS-a*
Rukovodiocima odeljenja MALS-a
Arhivi MALS-a



01/Nr. 465/2014

Në bazë të Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 neni 11, 40 pika 1, 73, Udhëzimit Administrativ Nr.2008/10 për Organizimin dhe Funksonimin e Komiteteve Konsultative neni 4.2, Statuti i Komunës së Hanit të Elezit neni 30, Kuvendi i Komunës së Hanit të Elezit në mbledhjen e mbajtur me datë 31.01.2014 miratoi:

V E N D I M I N

PËR CAKTIMIN E KRITEREVE PËR SHPALLJEN E KONKURSIT PËR KOMITETET KONSULTATIVE

I

Kuvendi i Komunës miratoi propozim vendimi me numër 02/Nr.465/2014 për caktimin e kriterëve për shpalljen e konkursit për Komitetet Konsultative në komunën e Hanit të Elezit.

II

Duke i referuar nenit I të këtij propozim vendimi, kriteret për shpalljen e konkursit përmbajnë:

- Japin propozime për rregullore të ndryshme sipas lëmvive përkatëse.
- Japin mendime dhe ide rreth iniciativave që i ndërmer Kryetari i Komunës, Komitetet e përlshme apo Kuvendi i Komunës në fushat përkatëse.
- Paraqesin pikëpamje dhe mendime të qytetarëve te Kryetari i Komunës dhe Kuvendi i Komunës.
- Paraqesin propozime për zgjidhjen e problemeve të identifikuar.
- Paraqesin ide apo propozime për hulumtime të ndryshme.

Mandati: Mandati i parë i anëtarëve të Komiteteve Konsultative është 3 (tre) vjeçar në baza të rregullta ku 1/3 (një e treta) e anëtarëve duhet të ndërrohet çdo vit.

Anëtarët e Komiteteve Konsultative mund të shërbejnë më së shumti për dy mandate të njëpasnjëshme si anëtarë të atyre komiteteve.

Kompensimi: Për punën e tyre në Komitetet Konsultative, anëtarët e këtyre komiteteve do të kompensohen konform me dispozitat e nenit 9 të Udhëzimit Administrativ Nr.16/2008 për pagesën e Stafit politik në Komuna.

Kushtet:

1. Të drejtë për të marrë pjesë në konkursin për anëtarësim në Komitetin Konsultativ kanë të gjithë qytetarët dhe përfaqësuesit e organizatave joqeveritare të Komunës së Hanit të Elezit të cilët janë njohës të fushave përkatëse.
2. Përfaqësimi gjinor në Komunitetin Konsultativ duhet të jetë në kuotën e 30%.
3. Kandidati për anëtar në Komunitetin Konsultativ duhet të jetë banor i Komunës së Hanit të Elezit.
4. Përgatitja profesionale- përparësi.

Dokumentet e kërkua:- CV, Diploma, Certifikata e lindjes, Kopje e letërnjohimit, Certifikata e vendbanimit

Kandidatët të cilët do të konkurrojnë do t'i nënshtrohen intervistimit.

Afati për dorëzimin e dokumenteve të kërkua është 30 ditë nga dita e shpalljes në gazetat publike.

Dokumentet e pa kompletuara dhe ato që arrijnë pas kësaj date nuk do të shqyrtohen .

III

Ky vendim hynë në fuqi ditën e miratimit nga kuvendi i komunës.

IV

Me këtë vendim njoftohen: Kryetari i Komunës, Ministria e Administrimit të Pushtetit Lokal, dhe Arkivi i Komunës.

Hani i Elezit

Data:31.01.2014

**Kryesuesi i Kuvendit
Qamush Brava**

